



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Konkursi artistik

Organizata Ndërkombëtare e Punës

Botimi që ju paraqesim, është pjesë e paketës së mjeteve didaktike SCREAM - Ndal Punës së Fëmijëve. SCREAM është shkurtimi i përcaktimit në gjuhën angleze "Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias". Kjo paketë është realizuar në kuadër të projektit INT/99/MO6/ITA, financuar nga Qeveria Italiane.

Botimi në gjuhën italiane është realizuar fal ndihmesës së Ministrisë së Punës dhe të Politikave Sociale, në bashkëpunim me Qendrën kombëtare të dokumentimit dhe të analizave për fëmijët dhe adoleshentët.

IPEC/ILO nxit prodhimin, ribotimin, përshtatjen dhe përkthimin e pjesshëm ose të plotë të këtij botimi, që të promovohet veprimtaria për të luftuar dhe për të eliminuar punën e fëmijëve. Kushdo që kryen përshtatjen apo përkthimin e këtij materiali, është i lutur të citojë burimin nga është marrë, si dhe të dërgojë një kopje të materialit në IPEC/ILO.

SCREAM - Ndal Punës së Fëmijëve.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias.

Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC),

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Gjenevë, 2003.

Botimi në shqip u mundësua nga Programi Kombëtar i IPEC në Shqipëri, me fonde të Qeverisë Italiane, nëpërmjet Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, FSASH.

ISBN 978-99943-59-04-2

"Medaur"

Përkthimi dhe përshtatja në gjuhën shqipe: As. prof. dr. Pranvera Kamani

Redaktimi: Sali Hamzaj

Për informacion të mëtejshëm për SCREAM, drejtohuni në:

Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC)

Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO)

4, Route des Morillons, CH-1211 Gjenevra 22, Svizera

Fax: + 41 22 799 81 81

E-Mail: scream@ilo.org

Internet: www.ilo.org/scream

Objektivi: Të organizohet një konkurs artistik me temë për punën e fëmijëve dhe të merret pjesë në të.



Përfundimi: Promovimi i shprehjes artistike të të rinjve, si dhe mbështetja e procesit edukativ për ndërgjegjësimin e komunitetit.

Koha

Tri orë mësimi, si dhe koha apo orë mësimi shtesë për përgatitjen e materialit artistik.

Motivimi

Arti viziv është një element shumë i rëndësishëm për ta bërë të prekshme dhe të dukshme punën e fëmijëve brenda grupit dhe më gjerë në komunitet. Nëse keni zhvilluar modulën e kolazhit, keni vënë re se puna e fëmijëve pothuajse nuk paraqitet fare në informacionin viziv. Për rrjedhojë, shoqëria mundet edhe të mos e vlerësojë fare a ta lërë mënjanë këtë dukuri. Për të tërhequr vëmendjen e publikut, si dhe për t'i dhënë fund mosvlerësimit të këtij problemi, duhet që ta bëjmë të pranishëm atë në mjedisin shoqëror.

Konkursi artistik do t'u japë mundësi të rinjve të shprehin artistikisht përfytyrimin e tyre për punën e fëmijëve në pikturë, skulpturë apo dhe nëpërmjet formave të tjera që shfrytëzojnë materiale të ndryshme, të cilat më pas do t'i paraqiten publikut në mënyrë që t'i shohin të gjithë. Pra kjo është një mënyrë e mirë për grupin që të shprehë mendimet e veta dhe nëpërmjet artit mesazhi të arrijë te komuniteti.



Edhe ky modul ndihmon rritjen dhe pjekurinë vetjake të pjesëtarëve të grupit, si dhe forcon më tej lidhjen e tyre në grup. Zhvillimi i kësaj veprimtarie do t'ju ndihmojë të nxirrni në pah aftësitë vetjake të të rinjve, siç janë: aftësitë drejtuese, aftësitë për të komunikuar etj., pasi ata do të punojnë në grup për realizimin e të gjithë veprimtarisë. Pa dyshim, edhe elementi i argëtimit do të përfshihet natyrshëm në këtë veprimtari, pasi vetë krijimtaria artistike është burim i krijimit të situatave tërheqëse.



Shënim për përdoruesin

Ky modul mund të zhvillohet në çdo kohë, por pas realizimit të moduleve të informacionit kryesor dhe të kolazhit. Meqë ky modul nuk lidhet me të tjerat, realizimi i tij bëhet kur ta shihni të arsyeshme. Gjithësesi, ky modul lidhet mirë me veprimtaritë që kanë të bëjnë me fushatën mediatike dhe shtypin.

Përgatitja



Moduli mund të zhvillohet në dy mënyra:

- Konkursi mund të bëhet vetëm për grupin (kjo është mënyra më e mirë nëse nuk keni kushte të përshtatshme për ta shtrirë atë më tej, p.sh., kur bëhet fjalë për një zonë rurale apo periferike).
- Konkursi mund të jetë më i hapur ndaj një komuniteti më të gjerë, nëse moduli zhvillohet në kushtet e një shkolle qytetit.

Për organizimin dhe zhvillimin e këtij moduli të mbani parasysh disa çështje:

- Meqë kolazhit i është lënë një modul më vete, është e arsyeshme që kjo formë e shprehjes artistike të mos përfshihet në konkurs.

- Çdo konkurs zhvillohet mbi bazën e një teme dhe objektivi. Për këtë të mbahen parasysh: cili është qëllimi përfundimtar i konkursit; a do t'u kërkohet në konkurs pjesëmarrësve të japin thjeshtë përfytyrimin e tyre për punën e fëmijëve; ç'vlerë duhet të ketë konkursi; a do të ishte mirë që të paraqesim shpresën për të ardhmen; a mund t'u kërkohet pjesëmarrësve të hartojnë një manifest për të promovuar projektin etj. Trajtimi i problemeve të tilla kërkon një diskutim të hapur dhe më pas diskutime edhe më të detajuara.

Shënim për përdoruesin

Në kuadër të këtij moduli nuk është e detyrueshme të zhvilloni të dyja veprimtaritë e përshkruara. Mund të zhvilloni vetëm njërin prej tyre. Nëse keni zhvilluar një konkurs të suksesshëm brenda grupit, siç përshkruhet në veprimtarin 1, dhe grupi mendon ta shtrijë këtë përvojë, mund të organizoni një konkurs të dytë ku të ftoni të gjithë komunitetin.



Nëse keni mundësi të përfshini në organizimin e konkursit mësuesit e lëndëve artistike dhe më gjerë, ndonjë prind etj., mos nguroni ta bëni.

Ndihma e jashtme

Për disa nga të rinjtë e grupit ndoshta nuk është e lehtë të shprehen në mënyrë artistike. Prandaj duhet t'i nxitni dhe t'i mbështesni ata. Shpesh ndodh që shprehja artistike është pasqyrim i ndjenjave intime, të cilat të rinjtë e kanë të vështirë t'i shprehin hapur. Duhet biseduar shtruar me ta, t'u shpjegohet se ndjenjat e tyre as nuk do të përfliten dhe as nuk do të jenë objekt talljeje.

Mirë është të zgjidhen forma të thjeshta të shprehjes artistike, si: vizatimi, ilustrimi, piktura etj. Nëse dëshironi të keni forma të tjera të shprehjes artistike: si: skulptura, stampimi në pëlhurë, grafikë kompjuterike etj., të kërkonin ndihmë të jashtme nga persona të specializuar. Qëllimi i vërtetë nuk është as mbingarkesa artistike dhe as shprehja

Çmimet dhe sponsorizimet



artistike si qëllim në vetvete. Qëllimi është t'i pajisësh të rinjtë me instrumente të ndryshme për t'u shprehur në mënyrë krijuese.

Si pjesë e integritit të komunitetit, të rinjtë e grupit duhet të shpërndahen nëpër organizata, tregje, ente prodhuese që ndodhen në komunitet dhe t'u kërkojnë atyre të sponsorizojnë çmimet që do të ndahen në konkurs. Mendohet se, fal natyrës që ka konkursi, ndërmarrjet e ndryshme do të jenë të gatshme të ndihmojnë.

Mirë është që para se të filloni mbledhjen e fondeve dhe të përcaktoni subjektet që do të sponsorizojnë, të diskutoni gjerësisht me pjesëmarrësit e grupit dhe të parapërgatisni takimet. Para se të merrni takim të drejtpërdrejtë me ndërmarrjet, në fillim lidhuni me telefon ose drejtojuni me shkrim. Orari i takimit do të lihet ta vendosë sponsori. Të rinjtë duhet të jenë të përgatitur dhe bindës në paraqitjen me kompetencë të qëllimeve, objektivave dhe veprimtarive të projektit. Kërkimi i fondeve të bëhet me edukatë. Nëse sponsori tërhiqet dhe nuk është i gatshëm të ndihmojë, të rinjtë duhet ta pranojnë qetësisht vendimin e tij. Nga ana tjetër, kërkimi i fondeve nga ana e të rinjve do të rrisë ndërgjegjësimin e komunitetit ndaj problemit të punës së fëmijëve dhe veprimeve që po ndërmarrin të rinjtë për ta luftuar këtë dukuri.

Sponsorët të nxiten të ndihmojnë duke u premtuar që emrat e tyre do të zënë një vend të dukshëm në këtë veprimtari, do të ftohen në natën përfundimtare dhe do të jenë ata vetë që do të shpërndajnë çmimet. Nëse keni zhvilluar më parë modulet e mjeteve të komunikimit dhe shtypit, mendojmë se të rinjtë do të kenë mësuar si duhet të sillen në raste të tilla. Gjithashtu, duhet të informoni mjetet e komunikimit publik të zonës për zhvillimin e konkursit dhe t'i ftoni në natën kur do të shpërndahen çmimet. Të gjitha këto do t'i nxisin sponsorët e fuqishëm të tregohen të pakursyer në dhënien e ndihmave. Përpiquni të siguronit në radhë të parë sponsorizimin e tri çmimeve të para (çmimet: një i parë, një i dytë dhe një i tretë). Grupi mund të vendosë të ndajë edhe vetëm tri çmime.


Pra ajo që ka rëndësi, është që grupi të sigurojë sponsorët, të organizojë ceremoninë e shpërndarjes së

çmimeve, si dhe të sigurojë pjesëmarrjen e shtypit në këtë veprimtari.

Nëse vendosni të organizoni një konkurs artistik, gjykimin apo vlerësimin e punimeve duhet ta bëjë një juri me profesionistë. Kjo është një mundësi e mirë për përfshirjen e komunitetit. Nëse më parë keni kërkuar ndihmën e një personi të jashtëm, ky mund t'ju ndihmojë në përzgjedhjen e anëtarëve të juri, madje ai vetë mund të jetë njëri prej tyre. Gjithashtu, mund t'u kërkoet disa prej sponsorëve të jenë anëtarë jurie. Në këtë mënyrë përfshihet edhe bota ekonomike e komunitetit që nëpërmjet punimeve të të rinjve do të sigurojë një informacion të caktuar për punën e fëmijëve.

Nëse dëshironi që konkursi të jetë i njohur nga një publik edhe më i gjerë, mund të përzgjidhni edhe pjesëtarë të grupit tuaj si anëtarë jurie. Madje kjo i ndihmon ata të zhvillojnë një ndjenjë me të fortë përgjegjësie në lidhje me zhvillimin e projektit. Por mund t'u kërkonit edhe të rinjve të tjerë të marrin pjesë në juri. Kështu, p.sh., mund të ftoni të marrin pjesë në juri të rinjtë e një klase tjetër, nëse projekti zhvillohet në shkollë.

Përbërja e juri



Ç'ju duhet



- ✓ Letër vizatimi, e bardhë dhe më ngjyrë, e përmasave të ndryshme.
- ✓ Lapsa me ngjyra dhe grafite.
- ✓ Penela, pastel dhe bojëra për pikturë.
- ✓ Libra të ndryshëm për artin, si dhe libra që flasin për punën e fëmijëve që do t'i ndihmojnë të rinjtë të krijojnë një përfytyrim të qartë për rëndësinë e problemit.
- ✓ Një dhomë të lirë me sipërfaqe të madhe.
- ✓ Një ose më shumë faqe muri ku do të varen punimet, pasi të jenë përfunduar.

Është e natyrshme që nëse sigurohet një pjesëmarrje e madhe e komunitetit, ndoshta nuk jeni të detyruar të siguronit materialet e mësipërme. Ato janë vetëm për të rinjtë e grupit.

Realizimi i projektit

Vënia në jetë e këtij moduli varet nga shumë faktorë, por realizimi i tij ka si qëllim kryesor të rrisë shkallën e ndërgjegjësimit të të rinjve dhe t'i nxisë ata të ndërmarrin veprimtari, në të cilat të përfshijnë sa më shumë të jetë e mundshme edhe komunitetin në luftën kundër punës së fëmijëve. Ideja është që konkursi artistik të ndihmojë në njohjen e problemit të punës së fëmijëve nga një numër gjithmonë e më i madh njerëzish.

Gjithësesi, është mirë që tema të jetë më e përcaktuar. Ajo t'u paraqitet pjesëmarrësve në konkurs me detaje, në mënyrë që t'i orientojë për mesazhin që duhet të përcjellë.

Një ndër mënyrat më të frytshme të gjetjes së ideve, është realizimi i një brainstormingu për të përcaktuar temën e konkursit. Orientohuni në gjetjen e një teme apo parrulle që do të përbëjë shpirtin e projektit.

Pasi të keni përzgjedhur temën, duhet të përgatisni paraqitjen e saj para pjesëmarrësve të konkursit. Është e natyrshme që kjo paraqitje nuk del e nevojshme, nëse konkursi zhvillohet me pjesëmarrësit e grupit. Nëse do të jetë i hapur për një pjesëmarrje më të gjerë, është e nevojshme t'u shpjegohet përse bëhet konkursi dhe çfarë pritet prej tij. Kërkojuni pjesëmarrësve në grup që vullnetarisht të përgatisin paraqitjen e konkursit në një faqe e gjysmë format A4. Paraqitja të përmbajë disa të dhëna statistikore për punën e fëmijëve dhe format më të këqija të shfaqjes së saj, pasojat negative që ka puna për shëndetin, edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve etj. Gjithashtu, në këtë paraqitje duhet të përshtatet tema dhe rregullat e pjesëmarrjes.



E domosdoshme është të jepen të gjitha detajet rreth afateve për paraqitjen e punimeve. Koha e përgatitjes së punimeve të jetë relativisht e shkurtër për të mos humbur interesin ndaj veprimtarisë. Kur kjo kohë është shumë e gjatë, interesi fillon e bie dhe kjo dobëson ndikimin që duhet të ketë realizimi i modulit. Paraqitje e konkursit të përmbajë edhe listën e çmimeve që keni mundur të siguronit.

Bashkëngjitur këtij moduli keni një model paraqitjeje të konkursit. Në të jepet lloji dhe niveli i informacionit që duhet të transmetohet tek pjesëmarrësit, si dhe pikat kryesore të konkursit. Vlen të theksohet se modeli që ju paraqitet, përbën thjesht një model orientues, pasi gjatë realizimit të konkursit, paraqitja që do të përgatisni, duhet t'u përshtatet kushteve, traditës dhe kulturës së vendit tuaj.

Qëllimi është të nxitësh të rinjtë e grupit të shprehin lirshëm. Të bëni gjithçka që secili pjesëtarë i grupit të prodhojë një krijim artistik. Mund të ndodhë që dy shokë kanë dëshirë të shprehin një ide në një vepër artistike së bashku. Në këtë rast, lejojini dhe shikoni se çfarë do të jenë në gjendje të bëjnë së bashku. Gjithësesi, është e rëndësishme të ndiqni me seriozitet përgatitjen e punëve kolektive. Nëse puna kolektive është një mënyrë për t'iu shmangur realizimit të modulit, atëherë ndajini të rinjtë të punojnë secili më vete.

Organizimi i grupit



Veprimtaria 1 Konkursi artistik

1 orë mësimi për të përcaktuar detajet e konkursit
1 orë mësimi për të vlerësuar punimet



Nëse konkursi do të zhvillohet me pjesëmarrësit e grupit, është e udhës që të bëni një përmbledhje të shkurtër, rreth 10 minuta, për atë që të rinjtë kanë bërë deri në këtë kohë. Më pas do të ndaleni në diskutimin e temës së konkursit, si dhe në llojet e punimeve që do të pranohen në konkurs. Gjithashtu, të bisedoni nëse grupi dëshiron të përgatisë një material, një poster apo lajmërim, që i njofton të tjerët për projektin. Po kështu, është mirë të qartësoheni nëse dëshira e tyre është që veprat e tjera artistike duan të paraqiten në mjediset e shkollës apo në një ekspozitë të veçantë më qëllim ndërgjegjësimin e gjithë komunitetin.

Pasi të jeni mirëkuptuar për objektivat dhe formën artistike të konkursit, grupi duhet të punojë për të përcaktuar sa kohë duhet për ta realizuar atë. Mund të parashikohen dy javë pune, gjatë të cilave të rinjtë do të punojnë për veprat e tyre. Gjatë kësaj kohe mund të parashikohen edhe seanca shtesë, gjatë së cilave grupi mund të punojë nën mbikëqyrjen e një specialisti.

Pasi të jenë përfunduar punimet, varini në muret e klasës ku të rinjtë kanë punuar, dhe ftoni jurinë e përzgjedhur të gjykojë rreth nivelit e cilësisë së tyre. Nxiteni grupin të analizojë dhe të gjykojë të gjitha punimet në detaje, si dhe secili anëtar i tij të shprehë mendimet dhe vlerësimet e veta, nëpërmjet një debati të gjallë. Ndoshta mund të zbuloni ndonjë talent të panjohur deri në atë kohë.

Veprimtaria 2

Konkursi artistik për një komunitet më të gjerë

1 orë mësimi për të organizuar konkursin
1 orë mësimi apo një shfaqje publike për të parë dhe për të gjykuar rreth punimeve artistike të paraqitura në konkurs

Nëse keni vendosur të bëni një konkurs me pjesëmarrjen e një komuniteti më të gjerë, duhet të njoftoni nëpërmjet një fletëlaajmërimi apo një posteri që do të varni në të gjitha mjediset e mundshme, në mënyrë që të gjithë ata që kanë dëshirë të marrin pjesë, të njihen me këtë ngjarje. Në lajmërim, shkurtimisht, do të jepen të gjitha detajet e konkursit, përfshi këtu dhe listën e çmimeve. Përfshini aktivisht të rinjtë e grupit në përgatitjen, shumfishimin e shpërndarjen e lajmërimin, si dhe ftojini ata të marrin pjesë në konkurs, nëse kanë dëshirë.

Pasi të keni marrë të gjitha punimet e paraqitura në konkurs, mblidhni jurinë për të vlerësuar punimet me çmimet. Mundohuni t'i bëni shumë reklamë konkursit në mënyrë që shpërndarja e çmimeve të kthehet në një ngjarje publike për komunitetin. Ceremonia e shpërndarjes së çmimeve duhet të jetë një ngjarje në të cilën do të ftohen mjetet e komunikimit lokal në mënyrë që fituesit dhe tema e punës së fëmijëve të jetë objekt vëmendjeje për të gjithë publikun. Mos harroni të falenderoni sponsorët sa herë që jeni në kontakt me mjetet e komunikimit.



Ç'duhet të bëni dhe ç'duhet të mënjaroni



Kujdesuni dhe mos lejoni që gara të bëhet elementi kryesor i konkursit. Qëllimi kryesor i modulit është që të rinjtë nëpërmjet kohës, hapësirës dhe materialeve që kanë në dispozicion, me sinqeritet të shprehen në gjuhën e artit. Nëse do të bëhet mbizotërues elementi i garës, ata që mendojnë se nuk janë në gjendje të prodhojnë një vepër artistike, do të ndiehen të dekurajuar.

Bëni të pamundurën që në konkurs të marrin pjesë të gjithë të rinjtë e grupit.

Të gjithë të rinjtë para se të kërkojnë sponsorët, të jenë vetë të mirëinformuar.

Respektoni afatet e përcaktuara dhe mbani gjallë interesin.

Ftojini sponsorët dhe personat e tjerë të përfshirë në konkurs, që të marrin pjesë në vlerësimin punimeve dhe në shpërndarjen e çmimeve.

Ruajini punimet e mbledhura dhe paraqitjani ato komunitetit në raste të caktuara.



Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi

Moduli i konkursit artistik është "argëtim". Pa dyshim, të rinjtë që marrin pjesë në këtë modul, argëtohen duke prodhuar punime artistike dhe duke vlerësuar punimet e të tjerëve, veçanërisht nëse janë caktuar të jenë anëtarë të jurisë. Gjithësesi, në përfundim të konkursit, pasi të rinjtë të jenë qetësuar, gjeni kohën për të diskutuar rreth punimeve artistike të paraqitura në konkurs.


Është e natyrshme që disa prej punimeve të kenë një cilësi të mirë dhe të tërheqin vëmendjen e publikut. Po kështu, është e rëndësishme që të gjitha punët të

analizohen dhe të vlerësohen për meritat që kanë. Bëhet fjalë për një shprehje artistike të asaj që autori mendon për punën e fëmijëve. Ndoshta shumë punime mund të jenë të dobta nga pikëpamja artistike, por, në fund të fundit, punimi që ata kanë bërë, është një vetëndërgjegjësim i problemit të punës së fëmijëve dhe jo indiferencë. Ka të rinj, të cilët thjesht e ndjejnë veten të paaftë për t'u përballuar me problemin e punës së fëmijëve dhe parapëlqejnë që paaftësinë e tyre ta fshehin pas një fasade indiference dhe mungese sinqeriteti.

Diskutoni me të rinjtë e grupit veprat artistike që i kanë terhequr dhe u kanë pëlqyer më shumë dhe pse u kanë pëlqyer. Kërkoni të tregojnë për përmbajtjen; të shprehen a ka shpresë në punimet e paraqitura; a shfaqin mungesën e të kuptuarit të problemit të punës së fëmijëve dhe nëse po, pse; a mendojnë të rinjtë e grupit se bashkëmoshatarët e tyre duhet të informohen rreth këtij problemi; si mund të realizohet; në përgjithësi, si mund të informohen të tjerët për punën e fëmijëve dhe pasojat që ka ajo për ta.

Ç'duhet të bëjmë ne?

Në përfundim të kësaj seance, është pikërisht kjo çështja më e rëndësishme: ç'mund të bëjmë për të ndërgjegjësuar gjithmonë e më shumë të tjerët dhe për t'i ftuar të bëjnë diçka për të ndihmuar dikë që është në vështirësi. Objektivi është që t'i kthejmë këta të rinj në forca lëvizëse që nxisin ndryshimin shoqëror në komunitetin ku bëjnë pjesë. Detyra jonë është t'i ndihmojmë për t'i përgatitur të luajnë këtë rol duke i pajisur me mjetet dhe njohuritë e duhura për të realizuar një veprimtari ndërgjegjësuese dhe ndihmuese konkrete.



Vlerësimi dhe vazhdimi

Për vlerësimin e modulit duhet të shikojmë si janë realizuar objektiva të caktuar. Të gjithë të rinjtë kanë përgatitur një vepër ku kanë paraqitur përfytyrimin e tyre për punën e fëmijëve. Forma që do të ketë kjo vepër, varet nga karakteri i individit, nga cilësia e realizimit të modulit dhe nga marrëdhëniet e krijuara ndërmjet edukatorit dhe grupit.



Në varësi të konkursit të organizuar, pas zhvillimit të këtij moduli, me qëllim që të forcohet besimi reciprok, ndërmjet të rinjve të grupit mund të organizohet një ekspozitë me punimet e paraqitura në konkurs. Do të ishte më mirë që ekspozita të hapet në të njëjtat mjedise ku u zhvillua dhe konkursi, p.sh., në shkollë. Grupi mund të sigurojë edhe një fond, duke shërbyer kafe, çaj apo edhe gjëra të tjera gjatë vizitës së ekspozitës. Madje, punimet edhe mund të shiten, duke i informuar vizitorët se fondet që do të mblidhen, do të financojnë veprimtari të tjera në ndihmë të luftës kundër punës së fëmijëve.

Kjo ekspozitë dhe shitja e punimeve të saj mund të kthehet në një moment të rëndësishëm fushate kundër punës së fëmijëve në kuadër të komunitetit lokal. Madje, punimet artistike mund të përdoren në një shkallë më të gjerë kombëtare, duke shfrytëzuar mjetet e komunikimit.

Realizimi i këtij moduli mund të ketë ndikim pozitiv edhe për zhvillimin e moduleve të tjera. P.sh., nëse keni vendosur të bëni modulën e dramatizimit, mund t'i përdorni këto punime si dekore për skenat ndryshme apo dhe për mjediset ku do të shfaqni dramën. Në këtë mënyrë do të krijoni një atmosferë më të përshtatshme për shikuesit për të ndjerë thellësisht problemin e punës së fëmijëve. Gjithashtu, kështu ndihmoni në lehtësimin e të kuptuarit të tematikës së punës së fëmijëve, duke e bërë atë çështje kryesore të gjithë veprimtarisë. Është mirë që këto punime të ruhen në vende të sigurta për t'u përdorur sa herë që paraqitet nevoja.

Ky modul është një mënyrë e thjeshtë, por shumë e frytshme për sensibilizimin e të rinjve për punën e fëmijëve, si dhe një mënyrë shumë e mirë për t'u shprehur. Jo rrallë njerëzit e kanë më të lehtë të shprehen nëpërmjet artit

sesa nëpërmjet fjalës dhe shkrimit. Madje, ndonjëherë figurat janë më shprehëse se vetë fjalët. Shprehja artistike i bën të rinjtë të ndihen më pak të kërcënuar dhe të ekspozuar.

Në punën me të rinjtë është e rëndësishme të shfrytëzosh ato forma shprehjeje që nuk kërcënojnë pozitën e tyre shoqërore në grup, që, njëkohësisht, nuk i ekspozojnë më shumë seç duhet. Me këtë modul mund të filloni t'u zbuloni të rinjve rolin e tyre edukativ në gjirin e komunitetit, si dhe mundësitë që kanë si forcë lëvizëse të ndryshimit shoqëror. E gjithë veprimtaria që duhet të zhvillojnë të rinjtë, është komplekse, pasi përfshin ata që duan të marrin pjesë në konkurs, në organizimin e konkursit, në shkrimin e njoftimit për zhvillimin e tij dhe në shpjegimin e qëllimit të projektit e të motivit pse kërkojnë sponsorizimi.

Pra, konkursi artistik është një proces i tërë i të mësuarit.

Mbani parasysh se zgjedhja se cilin modul do të realizoni, varet nga grupi dhe, mbi të gjitha, nga strategjia që keni zgjedhur ju si edukator. Nëse nuk e keni bërë, pas këtij moduli mund të kaloni në realizimin e modulit të figurës apo të shkrimit krijues.



Shtesa 1

Konkursi artistik "SCREAM, Projekti për Punën e Fëmijëve"

(organizuar pranë Kolegjit Komunitar Scariff, në Republikën e Irlandës, mars 2001)

Rregullat e pjesëmarrjes në konkurs

Konkursi është i hapur për të gjitha moshat e nxënësve. Në konkurs mund të marrin pjesë vetëm nxënësit e kësaj shkolle.

Afati i fundit për pranimin e punimeve është 29 mars 2001, ora 12.00. Pas kësaj kohe nuk do të pranohen më punime.

Punimet duhet t'i dorëzohen personalisht (z./ znj., mësuese e vizatimit) ose mund të dorëzohen në sekretarinë e shkollës. Autorët e punimeve në pjesën e mbrapme të punimit duhet të shkruajnë emrin, moshën, adresën.

Të gjitha punimet të paraqiten në origjinal. Nuk do të pranohen punime në kolazh. Punimet mund të paraqiten edhe pa ngjyra, pasi vlera e tyre do të gjykohet mbi bazën e përmbajtjes artistike dhe përqasjes me temën e konkursit.

Punimet që do të marrin çmim, nuk do t'i kthehen autorit.

Juria përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët janë: mësuesja e vizatimit, bashkërenduesi i projektit dhe tre nxënës që do të caktohen nga viti i katërt. Dhënia e çmimeve nga juria (I, II dhe III), është e pakundërshtueshme.

Çmimet janë: për vendin I tri kuti me çokollata, për vendin II dy kuti me çokollata dhe për vendin III një kuti me çokollata. Emrat e fituesve do të shpallen në tabelën e shkollës më 5 prill 2001. Ceremonia e dhënies së çmimeve do të zhvillohet në sallën e shkollës, më 8 prill 2001.

Pjesëmarrësit duhet të bëjnë një poster për punën e fëmijëve që të ketë shenjën SCREAM (britëm). Pjesëmarrësit janë të lirë ta shprehin ashtu siç e mendojnë vizionin e tyre për punën e fëmijëve, si dhe të fusin shenjën SCREAM në atë mënyrë që ata e gjykojnë më të përshtatshme. Punimet mund të paraqiten në çdo lloj letre, me ngjyrë ose jo, por jo më e vogël se formati A4.

Për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë konceptin e temës së konkursit,

më poshtë po ju përcjellim një përshkrim të detajuar të punës së fëmijëve dhe të SCREAM.

Juria do të vlerësojë edhe mënyrën si keni futur në punim SCREAM-in, si dhe krijimtarinë dhe origjinalitetin me të cilën keni shpjeguar që të rinjtë mund të bëjnë diçka konkrete për të kundërshtuar dukurinë e punës së fëmijëve.

Tema e konkursit

Puna e fëmijëve është përcaktimi që i është bërë gjendjes së fëmijëve në të gjithë botën, të cilët janë të detyruar të punojnë për të mbijetuar. Më shumë se 245 milionë fëmijë në botë punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme. 180 milionë prej tyre punojnë në kushte "të rrezikshme" për jetën.

Llojet e punëve që bëjnë fëmijët, janë të ndryshme: punë shtëpiake, pjesëmarrje në konflikte të armatosura, prostitucion, punë në bujqësi, punë në miniera, mbledhje plehërash, punë në ndërtim, prodhim tullash, në industrinë e përpunimit të gurëve të çmuar etj. Dallimi ndërmjet një fëmije irlandez që punon me dëshirën e vet për të fituar para për t'i shpenzuar si të dëshirojë, dhe një fëmije që punon, qëndron në respektimin e të drejtës së njeriut për lirinë e zgjedhjes. Fëmijët që punojnë, nuk kanë liri të zgjedhin. Ata ose duhet të punojnë, ose duhet të vdesin nga uria së bashku me familjen e tyre. Ata nuk kanë të drejtë të edukohen dhe të mësojnë në shkollë. Si rrjedhojë, gjatë kësaj kohe ata humbin fëmijërinë e tyre. Në disa raste hiqen nga familjet e tyre dhe shiten si skllëvër qysh në moshë të re.

Punojnë shumë orë në ditë. Jo rrallë me ta abuzohet fizikisht, psikologjikisht dhe seksualisht. Mund të kthehen në persona me paaftësi të qëndrueshme si rrjedhojë e mungesës së ushqimit, të gjumit dhe nga puna e rëndë. Privohen nga fëmijëria, nga shoqëria dhe shkollimi. Janë të detyruar të kenë një të ardhme të vështirë dhe i njëjti fat i pret edhe fëmijët e tyre.

Të gjithë, veçanërisht të rinjtë, duhet të informohen për pasojat shkatërruese që ka puna e fëmijëve, edhe nëse kjo dukuri nuk ndeshet në vendin e tyre. Të gjithë duhet të dinë se ç'pasoja të rrezikshme ka puna në zhvillimin fizik, mendor dhe shpirtëror të fëmijëve, madje të gjithë duhet të indinjohen deri në atë pikë që të dëshirojnë të bëjnë diçka në lidhje me këtë problem. Është koha që fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë të njihen në lidhje me këtë problem, të shprehin tronditjen e tyre, dënimin kundrejt kësaj padrejtësie, si dhe t'i trasmetojnë mesazhin e tyre komunitetit.

Duhet të BËRTASIN (SCREAM) në shprehjen e protestës së tyre dhe të ndër marrin veprime konkrete për të ndryshuar gjërat.

SCREAM do të thotë **Suport Children Rights through Education, the Arts and the Media** (Mbrojtja e të Drejtave të Fëmijëve Nëpërmjet Edukimit , Artit

dhe Medias). Ky është thelbi i projektit të zhvilluar me nxënësit e vitit të 4-t dhe SCREAM është mesazhi që duam të trasmetojmë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kjo është arsyeja që duam të bëjmë një manifest që të mbështesim projektin.

Manifesti që do të fitojë, do t'i dërgohet agjensisë së Kombeve të Bashkuara, ILO (Organizatës Ndërkombëtare të Punës) .

Ftojme të gjithë ta marrin pjesë dhe t'u japin liri të plotë aftësive të tyre krijuese. Mendoni për fjalën SCREAM dhe gjithëçka që do të thotë. E më pas mendoni për punën e fëmijëve, për dëshpërimin, për trishtimin, për vuajtjen dhe gjeni mënyrën për t'i shkrirë këto imazhe në një të vetme, duke tërhequr vëmendjen e të gjithëve.

Punë të mbarë!